Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 24
Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura

Objektivi

1 Objektivi i këtij Standardi është të sigurojë që pasqyrat financiare të një njësie ekonomike përmbajnë dhënien e informacioneve shpjeguese të domosdoshme për të tërhequr vëmendjen në mundësinë që pozita e saj financiar edhe fitimi apo humbja mund të jenë ndikuar nga ekzistenca e palëve të lidhura dhe nga transaksionet dhe shumat e papaguara me këto palë.

Objekti

2 Ky standard do të zbatohet në:

(a) identifikimin e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura;

(b) identifikimin e shumave të papaguara midis një njësie ekonomike dhe palëve të lidhura me të;

(c) identifikimin e kushteve në të cilat kërkohet dhënia e informacioneve shpjeguese në (a) dhe (b); dhe

(d) përcaktimin e informacioneve shpjeguese për t'u dhënë rreth këtyre çështjeve.

3 Ky Standard kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese të transaksioneve me palët e lidhura, transaksioneve dhe tepricave të papaguara, përfshirë angazhimet, në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale të një shoqërie mëmë, sipërmarrësi ose të investitorëve me kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi të investuarin të paraqitura në përputhje me SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara* ose SNK 27 *Pasqyrat financiare individuale*. Ky Standard zbatohet edhe për pasqyrat financiare individuale.

4 Për transaksion me palët e lidhura dhe tepricat me njësitë e tjera ekonomike në një grup jepet informacion shpjegues në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike. Transaksionet dhe tepricat brenda grupit të palëve të lidhura eliminohen gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, me përjashtim të atyre midis një njësie ekonomike investuese dhe filialit të saj të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Qëllimi i dhënies së informacioneve shpjeguese për palët e lidhura

5 Marrëdhëniet e palëve të lidhura janë një tipar normal i tregtisë dhe biznesit. Për shembull njësitë ekonomike zakonisht realizojnë pjesë të veprimtarive të tyre nëpërmjet filialeve, sipërmarrjeve të përbashkëta dhe pjesëmarrjeve. Në këto kushte, aftësia e njësisë ekonomike për të ndikuar politikat financiare dhe te shfrytëzimit të investitorëve është nëpërmjet pranisë së kontrollit, kontrollit të përbashkët apo influencës së konsiderueshme.

6 Një marrëdhënie e palëve të lidhura mund të ketë një efekt mbi fitimin apo humbjen dhe pozitën financiare të një njësie ekonomike. Palët e lidhura mund të hyjnë në transaksione të tilla që palët e palidhura nuk munden. Për shembull, një njësi ekonomike që shet mallra me një kosto të caktuar për shoqërinë mëmë mund të mos ia shesë me këto terma një konsumatori tjetër. Gjithashtu, transaksionet midis palëve të lidhura mund të mos bëhen me të njëjtat shuma si midis palëve të palidhura.

7 Fitimi apo humbja dhe pozita financiare e një njësie ekonomike mund të ndikohet nga një marrëveshje e palëve të lidhura edhe kur transaksionet midis palëve nuk ndodhin. Ekzistenca e dukshme e marrëdhënies mund të jetë e mjaftueshme për të ndikuar transaksionet e njësisë me palët e tjera. Për shembull, një filial mund të ndërpresë marrëdhëniet me një partner tregtar mbi blerjen nga shoqëria mëmë e një nën filiali të angazhuar në të njëjtin aktivitet sikurse partneri tregtar i mëparshëm. Në mënyrë alternative, një palë mund të shmanget nga veprimi për shkak të influencës se konsiderueshme të një tjetri - për shembull, një filial mund të udhëzohet nga shoqëria mëmë e tij për të mos u angazhuar ne kërkime dhe zhvillime.

8 Për këto arsye, njohja e transaksioneve me palët e lidhura, shumat e papaguara dhe marrëdhëniet mund të ndikojë vlerësimet e operacioneve të një njësie ekonomike nga përdoruesit e pasqyrave financiare, përfshirë vlerësimet e risqeve dhe mundësitë e përballimit të njësisë.

Përkufizimet

9 **Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:**

Një *palë e lidhur* është një person apo njësi ekonomike që është e lidhur me njësinë ekonomike e cila është duke përgatitur pasqyrat e saj financiare (në këtë standard është referuar si 'njësia ekonomike raportuese').

(a) Një person ose një anëtar i afërt i familjes së atij personi është i lidhur me një njësi ekonomike raportuese nëse ai person:

(i) kontrollon, ose është nën kontrollin e përbashkët me, njësinë ekonomike (kjo përfshin shoqërinë mëmë, filialet dhe nën-filialet);

(ii) ka influencë të konsiderueshme mbi njësinë raportuese; ose

(iii) është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë ekonomike raportuese ose të një kompanie mëmë të njësisë raportuese.

(b) Një njësi ekonomike është e lidhur me një njësi ekonomike raportuese nëse zbatohet ndonjë prej kushteve në vijim:

(i) Njësia ekonomike dhe njësia raportuese janë anëtarë të të njëjtit grup (që do të thotë se çdo shoqëri mëmë, filial dhe filial pjesëmarrës është e lidhur me të tjerët).

(ii) Një njësi ekonomike është një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët ose e njësisë tjetër (apo një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët e një anëtari të një grupi tek i cili njësia ekonomike tjetër është anëtar).

(iii) Të dyja njësitë ekonomike janë sipërmarrje të përbashkëta të së njëjtës palë të tretë.

(iv) Një njësi ekonomike është një sipërmarrje e përbashkët e një njësie ekonomike të tretë dhe njësia ekonomike tjetër është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike të tretë.

(v) Njësia ekonomike është një skemë e përfitimeve të pas-punësimit për përfitimet e punonjësve ose të njësisë ekonomike raportuese ose të një njësie ekonomike të lidhur me njësinë ekonomike raportuese. Nëse njësia ekonomike raportuese është në vetvete një skemë e tillë, punëdhënësit sponsorizues janë gjithashtu të lidhur me njësinë ekonomike raportuese.

(vi) Njësia ekonomike është e kontrolluar apo bashkërisht e kontrolluar nga një person i identifikuar në pikën (a).

(vii) Një person i identifikuar në (a)(i) ka ndikimin të konsiderueshëm mbi njësinë ekonomike ose është një anëtar i personelit kryesor të drejtimit të njësisë (ose i një kompanie mëmë të njësisë ekonomike).

(viii) Njësia ekonomike, ose çdo anëtar i grupit ku bën pjesë, ofron personel drejtues kryesor për njësinë raportuese ose për shoqërinë mëmë të njësisë raportuese.

***Një transaksion i një pale të lidhur* është një transferim burimesh, shërbimesh ose detyrimesh ndërmjet njësisë ekonomike raportuese dhe një pale të lidhur, pavarësisht se çfarë çmimi ngarkohet.**

***Familjarët e afërm të një individi* janë ata anëtarë të familjes të cilët kane mundësi të influencojnë, ose të influencohen nga ky individ në marrëdhëniet e tyre me njësinë ekonomike dhe përfshijnë:**

(a) fëmijët e atij individi dhe bashkëshortin/bashkëshorten dhe ose partnerit vendas;

(b) fëmijët e bashkëshortit/bashkëshortes së atij individit ose të partnerit vendas; dhe

(c) personat në ngarkim të atij individit, ose të bashkëshortit/bashkëshortes së atij individi ose të partnerit vendas.

***Kompensimi* përfshin të gjithë përfitimet e punonjësit (siç përcaktohet në SNK 19 *Përfitimet e Punonjësit*) përfshirë përfitimet e punonjësit për të cilat zbatohet SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione*. Përfitimet e punonjësve janë të gjitha format e shpërblimeve të paguara, te pagueshme ose të dhëna nga njësia ekonomike, ose në emër të njësisë ekonomike, në këmbim për shërbimet e kryera për njësinë ekonomike. Ajo përfshin gjithashtu pagesat/kompensimet e kryera në emër të kompanisë mëmë të njësisë ekonomike në lidhje me njësinë ekonomike. Kompensimi përfshin:**

(a) përfitimet afatshkurtra të punonjësve, siç janë pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, lejet e pagueshme vjetore dhe lejet e pagueshme për sëmundje, fitimin e

 © Fondacioni i SNRF-ve

shpërndarë dhe shpërblimet (nëse janë të pagueshme brenda dymbëdhjetë muajve nga fundi i periudhës) dhe përfitimet jo-monetare (siç janë kujdesi mjekësor, strehimi, makinat dhe mallrat apo shërbimet falas ose të subvencionuara) për punonjësit aktualë;

(b) përfitimet pas punësimit siç janë pensionet, përfitimet të tjera të daljes në pension, sigurimi jetës pas punësimit dhe kujdesi mjekësor pas punësimit;

(c) të tjera përfitime afatgjata të punonjësve, përfshirë lejet për shërbim të gjatë ose lejet e fundjavave, përvjetorëve apo shërbime të tjera afatgjata dhe, nëse ato nuk janë tërësisht të pagueshme brenda dymbëdhjetë muajve pas mbylljes së periudhës, shpërndarjen e fitimit, shpërblimet dhe kompensimet e shtyra;

(d) përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës; dhe

(e) pagesa të bazuara në aksione.

***Personeli drejtues kryesor* janë ata persona që kanë autoritet dhe përgjegjësi për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë ekonomike, direkt ose indirekt, duke përfshirë çdo drejtor (qoftë ekzekutues apo tjetër) të asaj njësie ekonomike.**

***Qeveritare* i referohet qeverisë, agjencive qeveritare dhe njësive të ngjashme, qofshin këto lokale, kombëtare ose ndërkombëtare.**

***Një njësi e lidhur me qeverinë* është një entitet që është i kontrolluar, bashkërisht kontrolluar ose ka një influencë të konsiderueshme nga qeveria.**

Termat 'kontroll' dhe 'njësi ekonomike investuese', 'kontroll i përbashkët' dhe 'influencë e konsiderueshme' janë përcaktuar në SNRF 10, SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta* dhe në SNK 28 *Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta* respektivisht dhe janë përdorur në këtë Standard me kuptimin që specifikohet në këto SNRF.

10 Kur konsiderohet çdo marrëdhënie e mundshme e palëve të lidhura , vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

11 Nga pikëpamja e këtij Standardi, nuk janë domosdoshmërisht palë të lidhura të mëposhtmet:

(a) dy njësi ekonomike sepse thjesht ato kanë një drejtor apo ndonjë tjetër anëtar të personelit drejtues kryesor të përbashkët ose sepse një anëtar i personelit drejtues të një njësi ekonomike ka influencë te konsiderueshme ndaj njësisë tjetër.

(b) dy sipërmarrës sepse thjesht ata ndajnë kontrollin e përbashkët mbi një sipërmarrje të përbashkët.

(i) ofruesit e shërbimit të financës,

(ii) shoqatat/bashkimet tregtare,

(iii) shërbimet komunale publike, dhe

(iv) departamentet dhe agjencitë qeveritare që nuk kanë kontroll më vete apo në bashkëpunim ose influencë të dukshme mbi njësinë raportuese,

(c) thjesht nga vetia e marrëveshjeve të saj normale më një njësi (edhe pse ato mund te ndikojnë në lirinë e veprimit të një njësie ose të marrin pjesë në procesin e saj vendimmarrës).

(d) një konsumator, ofertues, franshizë, shpërndarës apo agjent i përgjithshëm me të cilin një njësi ekonomike bën transaksione me një volum të rëndësishëm të biznesit, thjesht nga virtyti i varësisë së rezultuar ekonomike.

12 Në përkufizimin e një pale të lidhur, një pjesëmarrje përfshin filialet e pjesëmarrjes dhe një sipërmarrje e përbashkët përfshin filialet e sipërmarrjes së përbashkët. Për rrjedhojë, për shembull, filiali i një pjesëmarrje dhe investitori që ka influence të konsiderueshëm mbi pjesëmarrjen, janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Dhënie informacionesh shpjeguese

Të gjitha njësitë ekonomike

13 Për marrëdhëniet midis shoqërive mëmë dhe filialeve do të jepen informacionet shpjeguese pavarësisht nëse ka pasur transaksione midis këtyre palëve të lidhura. Një njësi ekonomike duhet të deklarojë emrin e shoqërisë së saj mëmë, dhe nëse ndryshon, palën kontrolluese përfundimtare. Nëse as shoqëria mëmë e njësisë dhe as pala kontrolluese përfundimtare nuk përgatisin pasqyra financiare të mundshme për përdorim publik, do të jepen informacione shpjeguese për emrin e shoqërisë më të afërt me statusin e mëmës që e bën këtë.

14 Për t'i bërë të mundur përdoruesve të pasqyrave financiare që të krijojnë një pamje mbi ndikimet e marrëdhënieve e palëve të lidhura të një njësie ekonomike, është e përshtatshme që të jepen informacione shpjeguese për marrëdhëniet e palëve të lidhura kur ekzistojnë kontrollet, pavarësisht nëse ka pasur transaksione midis palëve të lidhura.

15 Kërkesa për të dhënë informacione shpjeguese në lidhje me marrëdhëniet e palëve të lidhura ndërmjet një shoqërie mëmë dhe filialeve të saj është në vijim të kërkesave për informacione shpjeguese në SNK 27 dhe SNRF 12 *Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike.*

16 Paragrafi 13 i referohet kompanisë mëmë më të vjetër. Kjo është kompania mëmë e parë në grup mbi kompaninë mëmë direkte që harton pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim publik.

17 Një njësi do të japë informacione shpjeguese për kompensimin e personelit drejtues kryesor në total për secilën prej kategorive të poshtëshënuara:

(a) përfitimet afat shkurtra të punonjësve;

(b) përfitimet pas punësimit;

(c) përfitime të tjera afatgjata;

(d) përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës; dhe

(e) pagesa të bazuara në aksione.

17A Nëse një njësi ekonomike merr shërbime për personel drejtues kryesor nga një njësi ekonomike tjetër ('njësi ekonomike drejtuese'), njësisë ekonomike nuk i kërkohet të aplikojë kërkesat e paragrafit 17 për kompensimet e paguara ose për t'u paguar nga njësia ekonomike drejtuese për personelin e saj drejtues apo për drejtorët e saj.

18 Nëse ka pasur transaksione midis palëve të lidhura, një njësi ekonomike do të japë informacione shtesë për natyrën e marrëdhënies së palëve të lidhura po ashtu dhe informacion rreth këtyre transaksioneve dhe pasqyrave të pozicionit financiar të papaguara të nevojshme për një kuptim të ndikimit të mundshëm të marrëdhënies mbi pasqyrat financiare. Këto kërkesa për informacione shpjeguese janë veç kërkesave në paragrafin 17. Minimalisht, dhënia e informacioneve shpjeguese do të përfshijë:

(a) shumën e transaksioneve;

(b) shuma e balancave të papaguara përfshirë angazhimet dhe:

(i) termat dhe kushtet e tyre, përfshirë nëse ato janë të sigurta, dhe natyrën e arsyetimit për t'u dhënë në shlyerje; dhe

(ii) detaje të çdo garancie të dhënë apo të marrë;

(c) provizione për borxhe të dyshimta lidhur me shumën e tepricave gjendje; dhe

(d) shpenzimin e njohur gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija dhe të dyshimta që rrjedhin nga palët e lidhura.

18A Shumat që njësia ekonomike duhet të paguajë për shërbimin e personelit drejtues kryesor që janë ofruar nga një njësi ekonomike drejtuese e veçantë duhet të jepen si informacion shpjegues.

19 Dhënia e informacioneve shpjeguese, të kërkuara nga paragrafi 18, do të bëhet veçmas për secilën prej kategorive të mëposhtme:

(a) shoqërinë mëmë;

(b) njësitë ekonomike me kontroll të përbashkët apo influencë të konsiderueshme mbi njësinë ekonomike;

(c) filialet;

(d) pjesëmarrjet;

(e) sipërmarrjet e përbashkëta në të cilat njësia është një sipërmarrëse;

(f) personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike ose shoqëritë mëmë të tij; dhe

(g) palë të tjera të lidhura.

20 Klasifikimi i shumave të llogarive te pagueshme dhe llogarive të arkëtueshme nga palët e lidhura në kategori të ndryshme siç kërkohet në paragrafin 19 është një zgjerim i kërkesës për dhënie të informacioneve shpjeguese në SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* për informacionin që ose paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar ose jepet si informacion

 © Fondacioni i SNRF-ve

shpjegues në shënimet. Kategoritë janë zgjeruar për të siguruar një analizë më të hollësishme të tepricave me palët e lidhura dhe për t'u zbatuar në transaksionet me palët e lidhura.

21 Më poshtë jepen shembuj të transaksioneve për të cilat jepet informacion shpjegues nëse ato janë një palë e lidhur:

(a) blerjet ose shitjet e mallrave (të përfunduara apo të papërfunduara);

(b) blerjet ose shitjet e pasurive (tokës) apo aktiveve të tjera;

(c) pagesa ose marrja e shërbimeve;

(d) qiratë;

(e) transfertat e kërkimit dhe të zhvillimit;

(f) transfertat sipas marrëveshjeve të licencimit;

(g) transfertat sipas marrëveshjeve financiare (përfshirë huat dhe kontributet e kapitalit në para/monedhë apo në natyrë);

(h) provizioni i garancive apo kolaterali;

(i) angazhimet për të kryer diçka nëse një ngjarje e veçantë ndodh ose nuk ndodh në të ardhmen, duke përfshirë kontratat përmbaruese[1] (të njohura ose panjohura); dhe

(j) shlyerja e detyrimeve në emër të njësisë ekonomike apo nga njësia ekonomike në emër të asaj pale të lidhur.

22 Pjesëmarrja e një njësie mëmë ose filiali në një skemë me përfitime të përcaktuara që ndan rreziqet me njësitë e grupit, është një transaksion mes palëve të lidhura (shih paragrafin 42 të SNK 19 (ndryshuar në 2011)).

23 Informacionet shpjeguese që tregojnë se transaksionet midis palëve të lidhura janë bërë sipas termave të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksionet e kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra tjetrën do të jepen vetëm nëse terma të tilla mund të vërtetohen.

24 Për çështje të një natyre të ngjashme mund të jepen informacione shpjeguese në total, përveç kur dhënia e informacioneve shpjeguese individuale është e nevojshme për të kuptuar ndikimin e transaksioneve me palët e lidhura në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.

Njësitë e lidhura me qeverinë

25 Një njësi raportuese është e përjashtuar nga kërkesat e paragrafit 18, për dhënie të informacioneve shpjeguese në lidhje me transaksionet me palët e lidhura dhe tepricave të papaguara, përfshirë angazhimet, me:

(a) një qeveri që ka kontroll ose kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme mbi njësinë raportuese; dhe

(b) një tjetër njësi ekonomike që është një palë e lidhur, sepse e njëjta qeveri ka kontroll ose kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme njëkohësisht mbi njësinë raportuese dhe njësinë tjetër.

26 Nëse një njësi ekonomike zbaton përjashtimin e përcaktuar në paragrafin 25, ajo duhet të japë informacion shpjegues në vijim në lidhje me transaksionet dhe tepricat e lidhura të papaguara të përmendura në paragrafin 25:

(a) emri i qeverisë dhe natyra e marrëdhënieve të saj me njësinë raportuese (p.sh. kontrolli, kontrolli i përbashkët ose influenca e konsiderueshme);

(b) informatat e mëposhtme në detaje të mjaftueshme për të mundësuar përdoruesit e pasqyrave financiare të njësisë ekonomike për të kuptuar efektin e transaksioneve me palët e lidhura në pasqyrat e tij financiare:

(i) natyra dhe shuma e secilit transaksion individualisht të rëndësishëm; dhe

(ii) për transaksione të tjera që janë kolektivisht, por jo individualisht, domethënës, një tregues cilësor apo sasior i shtrirjes (madhësisë) së tyre. Llojet e transaksioneve përfshijnë ato të shënuara në paragrafin 21.

---

[1] SNF 37 *Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara* përcakton kontratat përmbaruese si kontrata nën të cilat asnjëra nga palët nuk ka kryer asnjë nga detyrimet e saj ose të dyja palët kanë përmbushur në mënyrë të pjesshme detyrimet e tyre në nivel të njëjtë.

27 Në përdorimin e gjykimin te tij për të përcaktuar nivelin e detajeve për t'u paraqitur në përputhje me kërkesat e paragrafit 26(b), njësia ekonomike raportuese duhet të konsiderojë afërsinë e marrëdhënies së palëve të lidhura dhe faktorët e tjerë te përshtatshëm në përcaktimin e nivelit të rëndësisë të transaksioneve të tilla nëse ato janë:

(a) të rëndësishëm në termat e madhësisë;

(b) kryhen në terma jo tregtare;

(c) jashtë aktivitetit normal ditor të biznesit, të tilla si blerja dhe shitja e bizneseve;

(d) zbulohen tek autoritetet rregullatorë ose mbikëqyrëse;

(e) raportohen tek drejtimi i lartë;

(f) i nënshtrohen miratimit të aksionarëve.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

28 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2011 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date ose i gjithë standardit ose me përjashtime të pjesshme në paragrafët 25–27 për njësitë ekonomike të lidhura me qeverinë. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2011, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

28A SNRF 10, SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta* dhe SNRF 12, të publikuara në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 3, 9, 11(b), 15, 19(b) dhe (e) dhe 25. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime kur të zbatojë SNRF10, SNRF 11 dhe SNRF 12.

28B *Njësitë ekonomike investuese (*ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në tetor 2012, ka ndryshuar paragrafët 4 dhe 9. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2014. Aplikimi më i hershëm i *Njësive Ekonomike Investuese* është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon këto ndryshime më herët, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në *Njësitë Ekonomike Investuese* në të njëjtën kohë.

28C *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012,* të publikuara në dhjetor 2013, paragrafi 9 ka ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 17A dhe 18A. Një njësi ekonomike do të aplikojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 korrik 2014. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

28D SNRF 18, i publikuar në prill 2024, ndryshoi paragrafin 20. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

Tërheqja e SNK 24 (2003)

29 Ky Standard zëvendëson SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura* (i ndryshuar në 2003).

 © Fondacioni i SNRF-ve